



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 482/ 2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të parregullsive gjate procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

## **A r s y e t i m**

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik FER, ne te cilën pretendohet se “me datë 12.12.2010 ne Kacanik, ne oren 22:20, ne QV 0701X vëzhguesit te cilët janë ndodhur brenda ne QV kane lajmëruar njerëzit te cilët ndodheshin jashtë, qe komisioneret dhe vëzhguesit e PDK-se kane filluar te shtojnë kandidatet për deputet ne ato fletëvotime ku nuk janë plotësuar 5 kandidat, psh një votues i ka votuar dy deputet dhe këtyre ju shtojnë edhe tre te tjerë. Anëtarët te cilët kane qene jashtë godinës kane tentuar te hynë brenda për ti mbrojtur votat, por gjate këtij momenti kane hasur rezistencën e policisë dhe policia ka tentuar ti arrestoj dhe nuk është arritur një marrëveshje”.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur asnjë provë, përveç se ka siguruar numër kontakt te Sherif Sopa, Refik Kodra, Mazif Burniku, Shabi Kodra, Jakup Kuka, ne cilësinë e dëshmitarit.

Ne baze te raportit policor, dt, 14.12.2010, te lëshuar prej Rreshterit Ismet Dervishi me numër identifikimi 5569, theksohet se “ne VV e larte cekur ne shkollën Emin Duraku, Kacanik, ne orën 22:00, ka arritur Basri Kodra, kandidat ne listën LVV-se, se bashku me 15 persona te tjerë dhe kane dashur te kontaktojnë me policinë, mirëpo Basri Kodra nuk ishte i qarte kur fliste, ne te njëjtën kohe fliste me dike tjetër ne

telefon dhe njoftonte se i ishin vjedhur votat, pa ditur se ku, ne çfare vendi dhe kush. Njëkohësisht Basri Kodra kërkonte te hynte brenda ne VV, porse policia nuk e lejoj qe te hyj pasi nuk kishte te drejte për te bere diçka te tille. Sipas Rreshterit Ismet Dervishi, vlen te theksohet se pasi ka ardhur Basriu ne lokalet e shkollës është njoftuar menjehere Toger Mehmetali Hajdini, prej te cilit është kërkuar qe te vije edhe nje parrulle tjeter policore me qellim qe te kontrollohej situata, mirëpo pasi parulla policore ka ardhur ne vendngjarje, te gjithë personat te cilët shoqëronin Basri Kodren janë larguar menjëherë pa pasur asnjë përplasje midis policisë dhe këtij grumbulli personash”. Gjithashtu policia ka bashkangjitur, deklaratën e Shabi Kodrës komisioner ne te cilën thuhet se gjate kohës kur ka pasur mosmarrëveshje midis vëzhguesve te partive, është ndërprerë procesi i numërimit te votave dhe pasi është zgjidhur kjo mosmarrëveshje procesi i numërimit te votave ka vazhduar rregullisht. Për me tepër ne deklaratën e Nazif Burnikut theksohet se pasi është mbyllur VV, ai ka vrejtur se komisionari i AAK ka plotësuar një numër te vogël te fletëvotimeve duke i mbushur 5 kandidat ne ato fletëvotime qe kishin me pak se 5 plotësime. Fletëvotimet sipas Burnikut kane qene te AAK\_se, mirëpo thekson se numërimi i votave është bere ne mënyrë te rregullt dhe se ne rastin kur komisioneret e partive te cilave iu përkasin, kane dashur ti numërojnë vet votat, Nazif Burniku nuk e ka lejuar diçka te tille.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**- ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara për shkakun se nuk është ofruar asnjë dëshmi apo prova të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar nga subjekti politik LVV. Ky fakt konfirmohet edhe përmes raportit te policise dt, 14.12.2010, te lëshuar prej Rreshterit Ismet Dervishi me numër identifikimi 5569 si dhe deklaratave te komisionereve te leshuara përpara organit policor përkatës, se nuk ka pasur asnjë problem ne lidhje me procesin e votimit dhe te numërimit te votave ne vendngjarje. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa**

A nr. 482/2010 më datën 16.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**

